



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 355 4 2268 141 /: 355 4 2268 142

Nr. 252/3 Prot.

Tiranë, më 04.10.2017

V E N D I M

Nr. 201, datë 04.10.2017

“Për heqjen e masës së pezullimit për procesin e verifikimit të statusit të punësimit në institucionin, Autoriteti i Aviacionit Civil”.

Bazuar në urdhrin nr. 344/1 prot., datë 11.05.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nisur procesin e verifikimit të rastit të *****, punonjës pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, në lidhje me parregullsi në procesin e deklarimit të statusit të punësimit në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil. Në bazë të këtij urdhri ka nisur edhe verifikimi i rastit, të dërguar me njoftimin nr. 344/4 prot., datë 11.05.2015, për punonjësin ***** (për institucionin “Njoftim mbi fillimin e verifikimit” nr. 344/2 prot., dt.11.05.2015).

Gjatë këtij procesi, Komisioneri është vënë në dijeni nga ana e Departamentit të Administratës Publike, me anë të shkresës nr. 1979/1, datë 13.05.2015, se nga ana e këtij institucioni, në mbështetje të kompetencës ligjore për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, ka filluar inspektimi me objekt deklarimin e statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e gjendur në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këtë arsye, me Vendimin nr. 48, datë 21.05.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është vendosur “Pezullimi i procesit të verifikimit të deklarimit të statusit të nëpunësit të Autoritetit të Aviacionit Civil deri në përfundim të rivlerësimit të akteve të deklarimit/refuzimit të statusit të punësimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike”.

Ndërkohë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka rënë në dijeni të disa pretendimeve të përsëritura, për parregullsi në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil. Në informacionin e regjistruar me nr. 252 prot., dt. 04.04.2017 dhe nr. 252/2 prot., dt. 14.09.2017, nëpunësi ***** pretendon se çështja e tij ende nuk ka marrë zgjidhje dhe për këtë arsye ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, për rregullimin e ligjshmërisë gjatë këtij procesi.

Për të ndjekur ecurinë e procesit, në zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, pika 3, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kërkuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe subjektit të inspektimit, në këtë

rast Autoriteti i Aviacionit Civil, të njoftohet në kohë reale, për të gjitha fazat nëpërmjet të cilave do të kalojë ky proces, duke dërguar aktet administrative që e materializojnë atë, deri në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit.

Në kushtet kur nëpunësi ***** pretendon se çështja e tij ende nuk është zgjidhur, si dhe në mungesë të përgjigjes nga ana e Departamentit të Administratës Publike, lidhur me procesin e ristrukturimit në të cilin është përfshirë subjekti në fjalë, Komisioneri çmon se duhet hequr masa e pezullimit, për të proceduar me hetimin e rastit.

Për këtë arsye:

Mbështetur në nenin 68, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe me qëllim që t’i hapet rruga vazhdimit të hetimit për gjendjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil,

VENDOSA:

1. Heqjen e masës së pezullimit për procesin e verifikimit të statusit të punësimit në institucionin, Autoriteti i Aviacionit Civil.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA